



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

Nr. 1505 prot.

Tiranë, më 15.12.2025

URDHËR

Nr. 171 data 15.12.2025

Në mbështetje të ligjit nr.8/2023 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor", Ligjit nr. 9367, datë 7.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, Ligjit nr 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e detyrimeve financiare, të cilat përfshijnë të drejtat e disa personave publikë", të ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, të Ligjit nr. 9131, datë 8.09.2003, "Për rregullimin e etikës në administratën publike", dhe të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores "*Për parandalimin e konfliktit të interesit dhe për deklarimin e pasurive në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror*".
2. Ngarkohen me zbatimin e saj punonjësit e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.
3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për përcjelljen e kësaj rregulloreje në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Ergys QIRICI





IRIA E DREJ

**RREGULLORE "PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT DHE PËR
DEKLARIMIN E PASURIVE NË SHËRBIMIN PËRMBARIMOR GJYQËSOR
SHTETËROR"**



KREU I: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1: Objekti

Neni 2: Baza ligjore

Neni 3: Fusha e zbatimit

Neni 4: Përkufizime

Neni 5: Castet paraprake të vendimmarrjes

Neni 6: Kompetenca përcaktuese në vendimarrje

Neni 7: Interesat private

KREU II : PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN, REGJISTRIMIN DHE TRAJTIMIN E KONFLIKTEVE TË INTERESAVE

Neni 8 : Deklarimi rast për rast i interesave privatë të zyrtarit

Neni 9: Identifikimi i interesave privatë të zyrtarit nga persona të tretë

Neni 10: Lëshimi i autorizimit

Neni 11: Autoritetet Përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave

Neni 12: Detyrat e autoritetit përgjegjës

Neni 13: Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave

Neni 14: Regjistrimet rast për rast të konflikteve të interesit

KREU III: ZYRTARËT QË MBARTIN DETRYRIMIN, LLOJI I INTERESAVE, KUFIZIMET

Neni 15: Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave privatë

Neni 16: Llojet e interesave privatë, që deklarohen periodikisht

Neni 17: Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta

REPUBLIQUE
PERGUTHES
DIREC
TRIA

Neni 18: Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale

Neni 19: Prania dhe kufizimi i interesave privatë të personave të lidhur me zyrtarin

Neni 20: Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesit

Neni 21: Mbrojtja për dhënien e informacioneve

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 22: Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës

Neni 23: Sanksionet



Neni 1 **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut nga zyrtarët e Shërbimit Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror si dhe përcaktimi i rregullave, mjeteve, procedurave, përgjegjesive dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe marrjen e masave ndëshkuese në rastet e konfliktit të interesave.

Neni 2 **Baza ligjore**

Rregullorja "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike si dhe për deklarimin e pasurive dhe të detyrimeve financiare në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror bazohet në nenin 46 të Ligjit nr. 9367, datë 7.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, në Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar, në Ligjin nr. 124/2014, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", në Ligjin nr. 9131, datë 8.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", në Ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit" si dhe Ligjit nr.8/2023 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror".

Neni 3 **Fusha e zbatimit**

1. Rregullorja përcakton norma të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo zyrtar i Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror që ndodhet në pozicione, ka përgjësësi, kryen detyra ose ushtron kompetenca të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr. 9367/2005 i ndryshuar dhe në ligjin nr. 9049/2003, i ndryshuar;

Neni 4 **Përkufizime**

1. "Konflikt i interesit" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

2. "Kryerje në mënyrë të drejtë e detyrave dhe përgjegjësive" është mënyra e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive, të materializuara në një vendimmarrje, në të cilën zyrtari vepron në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanshmëri, përgjegjësi, përkushtim, në afat, në mbrojtje, në çdo rast, të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme të personave privatë, si dhe për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë e të dinjitetit të institucionit ku punon, të shtetit në përgjithësi dhe të figurës së zyrtarit.

3. "Kryerje në mënyrë të padrejtë e detyrave dhe e përgjegjësive" është rasti kur nuk plotësohet të paktën njëra prej kërkesave të pikës 2 të këtij neni për shkak dhe vetëm të ndikimit të mundshëm të interesave privatë të zyrtarit, sipas pikës 1 të këtij neni.



4. Konflikti i interesit, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:

a) "konflikt faktik i interesit" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij zyrtare;

b) "konflikt në dukje i interesit" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësisë të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë;

c) "konflikt i mundshëm i interesit" është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara; ç) "konflikt rast për rast i interesit" është gjendja me konflikt interesi, në njërin nga tri llojet e mësipërme, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimarrje të veçantë;

d) "konflikt i vazhdueshëm i interesit" është gjendja, në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen. 5. "Zotërim aktiv i aksioneve ose i pjesëve në kapital" është ushtrimi i plotë i të gjitha të drejtave, që burojnë nga pronësia mbi aksionet ose pjesët në kapital.

5. "Zyrtar" është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike, sipas përcaktimit të shkronjave "a", "b" e "c" të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr.9367/2005 i ndryshuar.

6. "Institucion publik" është çdo subjekt, i përcaktuar në shkronjat "ç" e "d" të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr.9367/2005 i ndryshuar.

7. "Epror i një zyrtari" është një zyrtar tjetër, një njësi organizative brenda institucionit publik, drejtuesi më i lartë i institucionit publik ose një organ i këtij institucioni, që ka kompetenca emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese, të drejtpërdrejta mbi këtë zyrtar, ose që i janë dhënë kompetenca të caktuara për zbatimin e këtij ligji.

8. "Institucion epror" është një institucion publik (ose organ i një institucioni publik) që, sipas ligjeve në fuqi, ka kompetenca rregulluese, emëruese, drejtuese, urdhëruese, vlerësuese ose kontrolluese mbi një institucion tjetër publik (ose organ të tij), ku, në këtë të fundit, një zyrtar kryen detyrat dhe ushtron kompetencat e tij. Roli epror ushtrohet në përputhje me ligjet, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve publike. Pavarësisht nëse një institucion epror mund të ketë njërin nga kompetencat e mësipërme, ai nuk mund të vlerësohet i tillë, nëse kjo do të çonte në cenimin e parimeve kushtetuese të ndarjes së pushteteve dhe të autonomisë institucionale.

9. "Parim i proporcionalitetit", sipas pikës 12 të nenit 3 të ligjit nr.9367/2005 i ndryshuar, është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësisë dhe kompetencave të një zyrtari, me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave vetjake.

Neni 5

Castet paraprake të vendimarrjes

Për qëllime të kësaj rregulloreje:

a. vendimarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;

SHOIPER
CASHIER
STORAE
MINI-RE

b. vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas germës "a" të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara si më poshtë:

i. hartimin e projektaktit nga zyrtari ose zyrtarët dhe dorëzimin organit apo zyrtarit kompetent për vendimmarrje;

ii. dhënien e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuar, nga çdo zyrtar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projektakt;

Neni 6

Kompetenca përcaktuese në vendimmarrje

1. Një zyrtar i shërbimit konsiderohet se ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.

2. Si kompetence thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt, përfshihet, në secilin nga çastet paraprake të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:

a. roli zyrtar urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negocimin, propozimin, këshillimin, miratimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;

3. Në secilin prej çasteve të mësipërme, zyrtari pjesëmarrës në vendimmarrje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, është i detyruar të deklarojë, në zbatim të pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr. 9367/2005 i ndryshuar, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë rënien në konflikt interesi

5. Në të njëjtat raste, eprori mund t'i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat private në zbatim të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.

6. Kur vlerësohet se ka rrezik për rënien në konflikt të interesit të zyrtarit, veprohet sipas nenit 37 të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar.

Neni 7

Interesat private

1. Interesat private të një zyrtari janë ato interesa ligji nr. 9367/2005, i ndryshuar, e konkretisht:

a). të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre;

b). çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;

c). dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;

d). negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;

e). angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër.

f). marrëdhënie:

i. familjare apo të bashkëjetesës;

ii. të komunitetit;

iii. etnike;

iv. fetare;

v. të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;



g) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.

3. Nëse në ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për kriteret e përcaktuara në ligjin 9367 datë 07.4.2005, i ndryshuar, dhe anasjelltas.

4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesi privat i zyrtarit nga ata të përcaktuar në nenin 5 të ligjit 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3 të ligjit të lartpërmendur.

KREU II

PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN, REGJISTRIMIN DHE TRAJTIMIN E KONFLIKTEVE TË INTERESAVE

Neni 8

Deklarimi rast për rast i interesave privatë të zyrtarit

1. Çdo punonjës i Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor, sipas përcaktimit të këtij termi në nenin 5 të kësaj rregulloreje, në organizimin e punës detyrohet të bëjë vetëdeklarim paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesave të tij privatë, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi.

2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtarët, kur kjo kërkohet eprori direkt. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.

3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për një akt.

Neni 9

Identifikimi i interesave privatë të zyrtarit nga persona të tretë

1. Ofrimi i informacionit për interesat privatë të zyrtarit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor është:

- a. detyrë e çdo zyrtari të institucionit që ka dijeni;
- b. e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi, që ka dijeni dhe që ka një interes në përgjithësi, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005.

2. Burime të tjera informacioni për interesat privatë të një zyrtari të shërbimit, mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në nenin 9 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar

Neni 10

Lëshimi i autorizimit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit vë në dispozicion të zyrtarëve të tij modelin e autorizimit, që këta të fundit duhet të plotësojnë, brenda 30 ditëve nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës.
2. Autorizimi dorëzohet në autoritetin përgjegjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit.

Neni 11

Autoritetet Përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave

1. Autoriteti qëndror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
2. Autoriteti ose strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji sipas hierarkisë në Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror janë:
 - a. Drejtori i Përgjithshëm
 - b. Kryetarët e Zyrave Përmbartimore Vendore
3. Autoriteti përgjegjës në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit, i cili zbaton detyrat e përcaktuara në ligjin nr.9367 dhe në nenin 13 të kësaj rregulloreje është Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.

Neni 12

Detyrat e autoritetit përgjegjës

Autoriteti përgjegjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit kryen detyrat e mëposhtme, sipas Udhëzimit Nr. 622, datë. 30.11.2012 të ILDKPI-së :

- a) Mbledh nga burime të ligjshme të dhëna për interesat privatë të zyrtarëve,
 - i. shpërndan dhe mbledh autorizimet e lëshuar nga zyrtarët e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror në zbatim të nenit 10 të ligjit nr 9367, datë 07/04/2005, i ndryshuar dhe nenit 11 të kësaj rregulloreje
 - ii. Mbledh të dhëna personale për zyrtarin, në emër të shërbimit, kudo që ato janë regjistruar në regjistrat publikë.
- b) Propozon nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore, si edhe ndryshimet në rregulloret e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave të institucionit.
- c) Verifikon dhe kontrollon burimin dhe vërtetësinë e këtyre të dhënave dhe vlerëson rastet konkrete të konflikteve të interesit.
- d) Plotëson dhe administron regjistrin e konflikteve rast pas rasti dhe mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e gjobave në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar;
- e) në bashkëpunim me sektorin e shërbimeve:



- i. marrin masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në konflikt interesi
- ii. orientojnë, vlerësojnë, kontrollojnë apo kryejnë hetim administrativ në lidhje me konfliktin e interesit të zyrtarëve të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, në përputhje me rregulloren

h) Autoriteti Përgjegjës në zbatim të përcaktimeve të bera në nenin 3 të ligjit nr .9049, datë 10.4.2003, *"Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike"*, i ndryshuar, duhet të përgatisë listën e zyrtarëve të cilët në varësi të funksionit që kryejnë mbartin detyrimin për deklarin të interesave private, dhe të dërgojë kopje të saj në ILDKPKI.

i) Informon zyrtarin lidhur me afatet ligjore brenda të cilave plotësohet dhe dorëzohet deklarata e interesave private, si edhe me sanksionet në rastet e refuzimit ose mosplotësimit brenda afatit ligjor.

Neni 13

Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave

1. Për regjistrimet e konflikteve rast për rast të interesave të zyrtarëve të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, krijohet regjistri me të njëjtin emër.
2. Regjistri i konflikteve rast për rast të interesave administrohet nga autoriteti përgjegjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit dhe respekton formën tip të miratuar nga ILDKPKI.

Neni 14

Regjistrimet rast për rast të konflikteve të interesit

Autoriteti përgjegjës i SHPGJSH, për çdo rast të shfaqjes së një konflikti rast për rast të interesit, regjistron identitetin e zyrtarit të saj, interesat privatë të tij, shkak për konflikt interesi, thelbin e konfliktit, palët e interesuara, burimin e të dhënave, mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre, si dhe vendimin që është marrë, mbështetur në këto të dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprore ose nga gjykatat.

KREU III

ZYRTARËT QË MBARTIN DETRYRIMIN, LLOJI I INTERESAVE, KUFIZIMET

Neni 15

Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarin periodik të interesave privatë

1. Deklarimi i interesave private periodike të zyrtarëve të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor, bëhet sipas kërkesave të kreut I të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.
2. Zyrtarët e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarime periodike të interesave private sipas nenit 3 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar janë Drejtori i Përgjithshëm i Përmbartimit dhe Kryetarët e Zyrave Përmbartimore.



3. Në zbatim të nenit 21 dhe 22 të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, mbartin detyrim për deklarim të interesave private periodike bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të zyrtarëve të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe kur këta të fundit nuk janë në të njëjtën gjendje familjare me zyrtarin.

4. Në rast largimi nga funksioni dhe në rast se nuk është më subjekt i deklarimit të interesave private periodike në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, brenda 15 ditëve nga momenti i largimit, Kryetarit i lind detyrimi për të plotësuar dokumentin zyrtar ***“Deklaratë pas largimit nga funksioni”***.

Neni 16

Llojet e interesave privatë, që deklarohen periodikisht

Interesat privatë, që deklarohen periodikisht, janë ato të përcaktuara në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10. 04.2003, i ndryshuar “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë”

Neni 17

Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e konfliktit rast për rast të interesit për çështje të veçanta

Zyrtarët e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror :

- a) nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik;
- b) nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies;
- c) nuk mund të jetë anëtar i partive politike dhe nuk mund të marrë pjesë në veprimtaritë e tyre;
- d) nuk mund të zotërojë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, të çdo forme.

2. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarët, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni zbatohen edhe për personat e lidhur me ta, bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit dhe bashkëshortit/es, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 24 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005,i ndryshuar.

Neni 18

Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale

1. Është e ndaluar që një zyrtar në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror të kërkojë, të pranojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, për familjen, të afërmit, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat, kur kjo mund të shkaktojë lindjen e një konflikti



interesi të çdo lloji, ose që ndikon ose duket sikur ndikon në paanshmërinë e kryerjes së detyrës a është ose duket sikur është shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.

- a. "Dhurata", sipas kësaj rregulloreje ka të njëjtin kuptim të përcaktuar në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në VKM-në nr.714, datë 22.10.2004;
 - b. Nuk konsiderohen si dhurata, në kuptim të këtij neni, dhuratat, të cilat i ofrohen zyrtarit si pasojë e lidhjeve farefisnore apo njohjeve personale që ai ka me dhuruesit, si edhe në rastin kur është e qartë se dhurata nuk ka asnjë lidhje me pozicionin dhe cilësinë si nëpunës i administratës publike, të personit, që merr dhuratën.
2. Zyrtari nuk duhet që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një zyrtar të një niveli më të lartë apo të afërm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga zyrtarë të një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.
3. Rregullat e mësipërme nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar punonjës ose kolegë të tjerë, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e nëpunësit.
4. Pranimi dhe vlerësimi i dhuratave bëhet sipas rregullave të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në VKM-në nr.714, datë 22.10.2004;
5. Në asnjë rast zyrtari i Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.
6. Përjashtohen vetëm rastet e përcaktuara me akte të organeve kompetente, të cilat lejojnë pranimin e dhuratave apo trajtimeve preferenciale për arsye protokollare

Neni 19

Prania dhe kufizimi i interesave privatë të personave të lidhur me zyrtarin

1. Person i lidhur me zyrtarin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, për kufizimet e interesave privatë të zyrtarëve, të përcaktuar në nenet 17 e 18 të kësaj rregulloreje janë përkatësisht:
- a) bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore, prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/ja;
 - b) çdo person fizik ose juridik, i cili, në lidhje me dhuratën, favorin, premtimin ose trajtimin preferencial, luan rolin e ndërmjetësit a të shkëmbyesit të interesave të lindur nga ky veprim.
2. Ndalimet dhe kufizimet për zyrtarin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, të përcaktuara në këtë rregullore, zbatohen edhe për personat e lidhur me të, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.



3. Kufizimet në lidhje me zotërimin të aksioneve, për zyrtarin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror dhe personin e lidhur me të, zbatohen drejtëpërdrejt parashikimet e nenit 24, pikat 4 e 5 dhe nenit 35, pikat 2 e 3, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

Neni 20

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesit

Mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesit për zyrtarët e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror bëhen sipas kreut IV të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar.

Neni 21

Mbrojtja për dhënien e informacioneve

1. Çdo shtetas, i cili ofron informacion të bazuar për rastet e konfliktit të interesave të padeklaruara nga zyrtarët e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, përfiton, mbrojtje të veçantë administrative, si më poshtë:

a)zyrtari i SHPGJSH, për të cilin jepet informacion, nuk mund të ushtrojë asnjë kompetencë administrative me efekte ndëshkuese mbi shtetasin informues dhe as të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme nga ky i fundit për shkak të dhënies së informacionit;

Neni 22

Ndalimi i shpërdorimit të së drejtës

1. Asnjëra nga dispozitat e kësaj rregulloreje nuk mund të interpretohet sikur i jep zyrtarëve të SHPGJSH, të drejta që të ndërmarrin ndonjë veprimtari ose të kryejnë ndonjë akt që synon cënimin e parashikimeve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe në këtë rregullore.

2. Në mungesë të parashikimeve të veçanta në këtë rregullore, zbatohen drejtëpërdrejt dispozitat e përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

Neni 23

Sanksionet

Shkeljet e detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar dhe ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 përbëjnë sipas rastit shkelje disiplinore, kundërvajtje administrative apo vepër penale, dhe ndëshkohen sipas parashikimeve ligjore në fuqi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më datë _____.2025

A U T O R I Z I M

Unë, i nënshkruari _____ (emër, atësi, mbiemër) me funksion (emërtimi i funksionit dhe institucionit publik) në datën // , në respekt të detyrimit tim ligjor sipas nenit 10, pika 2, si dhe nenit 41, pika 2 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, autorizoj Institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit që të kryejë kontroll dhe të sigurojë të dhëna vetjake për personin tim, kudo ku ato janë të regjistruara dhe që lidhen me llojet e interesave privatë të përcaktuara në nenin 5, me përjashtim të atyre të dhënave personale të përcaktuara në pikën 4, të nenit 7, të këtij ligji.

Autorizimi ka vlerë për të gjithë kohën që unë ushtoj detyrën publike, e cila është subjekt i kontrollit dhe i verifikimit sipas ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Gjithashtu, ky autorizim ka vlerë për çdo kohë, pavarësisht nga mosvazhdimi i detyrës sime publike, por vetëm për ato të dhëna të interesave të mi privatë, të cilat mund të lidhen me ushtrimin e detyrës publike në kohën e ushtrimit të saj. Të gjitha veprimet për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna personale, të kryera nga institucionet ose personat e autorizuar prej tyre i konsideroj sikur janë kryer nga unë vetë. Çdo person fizik ose juridik, publik ose privat, nuk duhet t’u nxjerrë pengesë personave konkretë që posedojnë origjinalin ose kopjen e njësuar me origjinalin të këtij autorizimi e të ngarkuar zyrtarisht, sipas ligjit për të kryer kontroll dhe për të siguruar të dhëna të interesave të mi privatë. Në bazë të ligjit nr. 124/2024, , “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, personi i ngarkuar për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave, detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.

Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

RISE 351
PERMBA

REP
APR
1983



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më datë _____.2025

**D E K L A R I M RAST PËR RAST I INTERESAVE PRIVATË TË ZYRTARIT NË
USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE**

Kush mbart detyrimin për deklaram rast për rast të interesavë private

Të gjithë zyrtarët e përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar,

Llojet e deklaramit:

1- Vetëdeklaram paraprak rast për rast të ekzistencës së interesave privatë, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi.

2- Deklaram rast për rast të interesave privatë të një zyrtari kur kërkohet nga eprori ose institucioni epror.

Të dhëna personale:

Emri Atësia Mbiemri _____

Funksioni _____

Institucioni _____

Lloji i deklaramit:

(Vendos X në kutizën për llojin e deklaramit.)

☐ Me kërkesë

☐ Vetëdeklaram

Vërtetoj se deklaramet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e tyre.

1- Përshkrimi i hollësishëm i interesave privatë që bëhen shkak për një konflikt interesi:

2- Përmbajtja e kufizimit ligjor në ushtrimin e funksioneve publike që bëhet shkak për një konflikt interesi:

3- Mënyra e zgjidhjes së konfliktit të interesave:

Data e dorëzimit të deklaratës:

Emri, mbiemri, nënshkrimi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më datë _____.2025

**REGJISTRI VJETOR I EVIDENTIMIT DHE ZGJIDHJES SË RASTEVE TË
KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Funksioni	Data e evidentimit	Pershkrimi i Konfliktit të interesit	Burimi i të dhënave dhe verifikimi	Mënyra dhe data e zgjidhjes së konfliktit	Shënime

Shënim: Ky regjistër është pjesë e raportit vjetor për veprimtarinë e kryer në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", në të cilin duhet të evidentohen rastet e konflikteve të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklarin periodik. Sqarimet në lidhje me rastet e konflikteve të interesave të detajohen në raportin vjetor të autoritetit përgjegjës. Regjistri vjetor i evidentimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave duhet të dërgohet i plotësuar në Inspektoratin e Lartë brenda datës 31 janar të çdo viti.

AUTORITETI PËRGJEGJËS
